



Udhëzime për përdorimin e sistemit ALPA

Eshref Januzaj

Augsburg, më 24.09.2010

Para hyrjes ...

Përdorimi i sistemit ALPA për dërgimin e punimëve është koncipuar dhe implementuar në atë menyrë, që ai të jetë i thjeshtë për përdorim. I tërë funksionaliteti dhe kompleksiteti i sistemit ndodhet në 'prapavijë', që do të thotë se shfrytëzuesi i këtij sistemi nuk ka nevojë që të konfrontohet me procese teknike e komplekse.

Sidoqofte, që për autorët të jetë edhe më e lehtë dërgimi i punimëve në një konferencë apo në një revistë shkencore, në këtë dokument do t'i gjeni disa udhëzime me shembuj praktik të përdorimit të sistemit ALPA.

Në këtë dokument janë të përshkruara të dy fazat e përdorimit të sistemit ALPA:

1. Krijimi i kontos
2. Dërgimi i punimëve përmes sistemit ALPA

Augsburg, më 24.09.2010

Eshref Januzaj
Mali-IT (mali-it.eu)
Kosovë - Gjermani


Përmbajtja

1. Krijimi i kontos	4
2. Dërgimi i punimëve përmes sistemit ALPA	8

1. Krijimi i kontos

Që të mund të punoni me sistemin ALPA, ju duhet që në fillim të krijoni një konto në sistemin ALPA. Krijimi i kontos i paraprind procesit të regjistrimit të punimëve në sistem dhe është hapi i parë që duhet të ndërmerren autorët që dëshirojnë të dërgojnë një punim në një konferencë apo revistë shkencore përmes ALPA-së.

Krijimin e kontos e bëni duke klikuar mbi nyjen (linku) **“Krijo konton”**.



Pasi që në ekran të ju jetë paraqitur formulari për krijimin e kontos, ju duhet që të plotësoni të gjitha fushat e kërkuar.

ALPA: AKTET - Revistë Shkencore e Institutit Alb-Shkenca - Mozilla Firefox

ALPA: AKTET - Revistë Shkencore e I...

AKTET
Journal of Institute Alb-Shkenca
Revistë Shkencore e Institutit Alb-Shkenca

(english)

Faqa kryesore
Data me rëndësi
Thirrja për kumtesa
Dërgimi i kumtesave
Editorët

Krijo konton
Lajmërohu në sistem
Ndihmë

Krijimi i një kontoje të re për dërgimin e punimëve

Ju lutem të plotësoni të gjitha rubrikat për të krijuar një konto të re në sistemin **ALPA - Albanian Papers** për dërgimin e punimëve për Revistën AKTET.

Kodi (login):

Fjalekalimi (password):

Perserite fjalekalimin (password):

Gjinia: Znj. Z.

Titulli shkencor: (Msc., Dr., Prof., Prof.Dr., etj.)

Emri:

Mbiemri:

Institucioni/Firma:

Adresa:

Qyteti:

Shteti: -- Select a Country --

E-Mail:

Shenoni ju lutem nje adrese te sakt!

Registro Pastro formularin

Fertig

Nëse nuk plotësoni fushat e kërkuara ashtu siç i kërkon sistemi ALPA, ju nuk mund të bëni krijimin e kontos tuaj në ALPA. Vërejtjet dhe gabimet e mundshme do t'u pataqiten në ekran.

ALPA: AKTET - Revistë Shkencore e Institutit Alb-Shkenca - Mozilla Firefox

ALPA: AKTET - Revistë Shkencore e I...

AKTET
Journal of Institute Alb-Shkenca
Revistë Shkencore e Institutit Alb-Shkenca

(english)

Faqa kryesore
Data me rëndësi
Thirrja për kumtesa
Dërgimi i kumtesave
Editorët

Krijo konton
Lajmërohu në sistem
Ndihmë

Krijimi i një kontoje të re për dërgimin e punimëve

Ju lutem të plotësoni të gjitha rubrikat për të krijuar një konto të re në sistemin **ALPA - Albanian Papers** për dërgimin e punimëve për Revistën AKTET.

Kodi (login): Ju lutem plotësoni rubriken **'Kodi'**

Fjalekalimi (password): Ju lutem plotësoni rubriken **'Fjalekalimi'**

Perserite fjalekalimin (password): Ju lutem plotësoni rubriken **'Fjalekalimi'**

Gjinia: Znj. Z. Ju lutem plotësoni rubriken **'Gjinia'**

Titulli shkencor: (Msc., Dr., Prof., Prof.Dr., etj.)

Emri: Ju lutem plotësoni rubriken **'Emri'**

Mbiemri: Ju lutem plotësoni rubriken **'Mbiemri'**

Registro Pastro formularin

Fertig

Disa nga fushat e formularit për krijimin e kontos duhet të plotësohen në bazë të disa rregullave obligative. Për shembull, **kodi (login)** duhet të ketë të paktën 6 shenja.

ALPA: AKTET - Revistë Shkencore e Institutit Alb-Shkenca - Mozilla Firefox

Datei Bearbeiten Ansicht Chronik Lesezeichen Extras Hilfe

ALPA: AKTET - Revistë Shkencore e I...

Faqja kryesore
Data me rëndësi
Thirrja për kumtesa
Dërgimi i kumtesave
Editorët

Krijoni konton
Lajmërohuni në sistemin
Ndihmë

Krijimi i një kontoje të re për dërgimin e punimëve

Ju lutem të plotësoni të gjitha rubrikat për të krijuar një konto të re në sistemin ALPA - Albanian Papers për dërgimin e punimëve për Revisten AKTET.

Kodi (login): Kodi duhet te kete 6 apo me shume germa! Ju keni shenuar vetem 4 germa!
kodi

Fjalekalimi (password):

Perserite fjalekalimin (password):

Gjinia: Znj. Z.

Titulli shkencor: (Msc., Dr., Prof., Prof.Dr., etj.)

Emri: Eshref

Mbiemri: Januzaj

Fertig

Gjatë zgjedhjes së një **fjalëkalimi (password)** duhet që të kujdesëni që të shënoni në të dy rastet fjalëkalimin (password) e njëjtë, përndryshe ALPA nuk lejon vazhdimin e procesit për krijimin e kontos. Ky funksion garanton që ju nuk e keni bërë pa dashje ndonjë gabim shtypi gjatë zgjedhjes së fjalëkalimit (password) tuaj.

ALPA: AKTET - Revistë Shkencore e Institutit Alb-Shkenca - Mozilla Firefox

Datei Bearbeiten Ansicht Chronik Lesezeichen Extras Hilfe

ALPA: AKTET - Revistë Shkencore e I...

Faqja kryesore
Data me rëndësi
Thirrja për kumtesa
Dërgimi i kumtesave
Editorët

Krijoni konton
Lajmërohuni në sistemin
Ndihmë

Krijimi i një kontoje të re për dërgimin e punimëve

Ju lutem të plotësoni të gjitha rubrikat për të krijuar një konto të re në sistemin ALPA - Albanian Papers për dërgimin e punimëve për Revisten AKTET.

Kodi (login): januzaj

Fjalekalimi (password): Fjalekalimet duhet te jene te njejta!!!
Korrigjoje!
.....

Perserite fjalekalimin (password): Fjalekalimet duhet te jene te njejta!!!
Korrigjoje!
.....

Gjinia: Znj. Z.

Titulli shkencor: (Msc., Dr., Prof., Prof.Dr., etj.)

Emri: Eshref

Mbiemri: Januzaj

Fertig

Është me rëndësi që kur të krijoni një konto, të zgjedhni **adresën elektronike (E-Mail)** të sakt dhe që ju e përdoni në të vërtetë për arsye se kjo adrese do të shërbej për komunikim të mëtutjeshëm me autorin (dërgimi i konfirmimit pas regjistrimit të punimit, kontakti me redaksinë, të dhënat që do të publikon në punim, konfirmimi për pranim të punimit, etj.).

Sistemi ALPA e ka të implementuar një mekanizëm që i bën një kontrollë adrese elektronike, nëse ju keni gabuar apo shënuar një adresë të pavlefshme.

Kodi (login):	januzaj
Fjalëkalimi (password):	*****
Gjinia:	Z.
Titulli shkencor:	
Emri:	Eshref
Mbiemri:	Januzaj
Institucioni/Firma:	ALPA
Adresa:	ALPA - Albanian Papers
Qyteti:	Isniq
Shteti:	KS
E-Mail:	alpa

Shenoni ju lutem nje adrese te sakt!

Adresa elektronike (E-Mail) qe ju keni shenuar "alpa" duket se eshte gabim!
Ju lutem kthehuni prapa dhe korrigjojeni.

Pasi që të keni shënuar të gjitha të dhënat ashtu siç duhet, ju do të keni mundësinë që në hapin e fundit të kontrolloni dhe korrigjoni edhe një herë të dhënat e shënuara.

Nëse keni shënuar të gjitha të dhënat në rregull dhe procesi i krijimit të kontos ka shkuar mirë, në fund të procesit do të merrni në ekran porosinë se konto është krijuar me sukses.

AKTET
Journal of Institute Alb-Shkenca
Revistë Shkencore e Institutit Alb-Shkenca

Krijimi i kontos u realizua me sukses.


Ju faleminderit per krijimin e kontos, Z. Eshref Januzaj.
Ju tash mund te lajmeroheni (login) ne sistemin ALPA ne cdo kohe per te bere dergimin e punimit tuaj permes ketij sistemi (online).

- Lajmerimi per dergimin e punimeve (me kodin dhe me fjalekalimin qe sapo e krijuat)
[Dergo nje punim](#)


Prej këtij momenti ju mund të futëni në sistemin ALPA për të bërë dërgimin e punimeve tuaja për një konferencë apo revistë shkencore.

2. Dërgimi i punimëve përmes sistemit ALPA


Pasi që të keni krijuar konton tuaj për punë me sistemin ALPA, ju tash keni mundësinë e dërgimit të punimëve për një konferencë apo revistë shkencore. Këtë e bëni duke klikuar mbi nyjen (linku) *“Lajmërohu në sistem”*.



Pas klikimit në nyjen (linkun) e mësipërm, juve do t’u paraqitet formulari për t’u lajmëruar në sistemin ALPA me kodin (login) dhe fjalëkalimin (password) që e keni krijuar në hapin e parë.




Të keni kujdes që të shënoni pikërisht ato të dhëna, me të cilat e keni krijuar konton. Në të kundërtën, ju nuk do të mund të futeni në ALPA.



Pasi të keni dhënë shënimet e sakta ju do të mund të futeni në sistemin ALPA. Me atë rast ju do të keni mundësinë e dërgimit të një punim të ri. Këtë e bëni duke klikuar mbi nyjen (linkun) „Regjistro një punim të ri”.




Nëse veç keni dërguar më parë ndonjë punim përmes sistemit ALPA te konferenca apo revista shkencore ku tash jeni duke dërguar punime, ju do të shihni listën e punimëve që i keni dërguar deri me tani (titujt në gjuhën shqipe dhe angleze). Nëse dëshironi që të korrigjoni të dhënat për punimin e dërguar, vetëm klikoni mbi titullin e punimit që do t'a shihni të listuar në ekran.




Që të dërgoni një punim të ri, klikoni mbi nyjen (linkun) „Registro një punim të ri”. Për të përfunduar punën dhe për të dalë nga sistemi, klikoni mbi nyjen (linkun) „dil nga sistemi”.



Në hapin tjetër ju do të keni mundësinë që të shënoni numrin e autorëve në punimin tuaj. Të keni parasyshë që autori kontaktues është njëri prej tyre.



Nëse nuk shënoni asnjë autor, në ekran do të merrni porosinë që punimi duhet të ketë të paktën një autor.



Pasi që të keni shënuar numrin e autorëve, shtypeni butonin ">> Vazhdo me hapin tjetër".

Kur të keni shënuar numrin e autorëve të punimit që jeni duke e regjistruar në sistemin ALPA (mos harroni së autori kontaktues, dmth. ju që jeni duke e plotësuar formularin, duhet të llogaritet në numrin e përgjithshëm të autorëve të punimit), ALPA do t'u ofroj një formularë për të shënuar të dhënat e të gjithë autorëve të punimit, mvarësisht se sa autor do të ketë punimi.

Në hapin pasues, ju do të keni mundësinë që të shënonin të dhënat për të gjithë autorët e punimit. Me këtë rast do të vëreni se për autorin kontaktues (ai i cili tash është duke e dërguar punimin) nuk keni nevojë që të shënoni sërish të dhënat e tij, pasi që ato do të lexohen vet nga ALPA. Për autorët e tjerë, duhet që të shënoni të gjitha të dhënat e kërkuara, ashtu siç keni bërë me rastin e krijimit të kontos tuaj. Të keni kujdes që të shënonin edhe me këtë rast të dhënat e sakta për çdo autor të punimit, pasi që këto të dhëna do të publikohen pastaj me rastin e botimit të punimit.

ALPA: AKTET - Revistë Shkencore e Institutit Alb-Shkenca - Mozilla Firefox

ALPA: AKTET - Revistë Shkencore e I...

Regjistrimi i (bashk)autorëve për një punim të ri

Ju lutem të plotësoni të gjitha rubrikat në formularin e mëposhtëm.

Autori nr.1	
Autori kontaktues (nr.1) : Radhitja e autorëve (i parë, i dytë, etj.) bëhet në hapat e ardhshëm.	Z. Eshref Jamuzaj (alpa@mali-it.eu) ALPA ALPA - Albanian Papers Qyteti: <i>Isniq</i> , Shteti: <i>Kosova</i>
Autori nr.2	
Gjinia:	<input type="radio"/> Znj. <input checked="" type="radio"/> Z.
Titulli shkencor:	<input type="text"/> (Msc., Dr., Prof., Prof.Dr., etj.)
Emri:	<input type="text" value="Gjergj"/>
Mbiemri:	<input type="text" value="Kastrioti"/>
Institucioni/Firma:	<input type="text" value="Kalaja e Krujes"/>
Adresa: Ë, Ç, Ë, Ç	<input type="text" value="Kalaja e Krujes
Kruje"/>
Qyteti:	<input type="text" value="Kruje"/>
Shteti:	<input type="text" value="Albania"/>
E-Mail: Shënoni ju lutëm një adrese të sakt!	<input type="text" value="gjergji@kruja.al"/>

Regjistro Pastro formularin

Fertig

Kur të keni shënuar të gjitha të dhënat për të gjithë autorët, shtypeni butonin “Finalizo regjistrimin”.

Nëse çdo gjë ka qenë në rregull, tash ju e keni mundësinë që të plotësoni fushat e kërkuara për të bërë regjistrimin e shënimeve për punimin tuaj.

ALPA: AKTET - Revistë Shkencore e Institutit Alb-Shkenca - Mozilla Firefox

ALPA: AKTET - Revistë Shkencore e I...

Data me rëndësi

Thirrja për kumtesa

Dëgjimi i kumtesave

Editorët

Krijoi konton

Lajmërohu në sistem

Ndihmë

Regjistro punimin tuaj

Ju lutem të plotësoni rubrikat për të dërguar një përmbledhje.

Titulli shqip:

Titulli anglisht:

Abstrakti shqip: (100 - 150 fjale)

Ë, Ç, ë, ç

α β Γ γ Δ δ ε ζ η θ ι κ λ μ ν ξ

Π ρ Σ σ τ υ φ ψ χ Ψ Ω ω

√ ∫ ∂ ∞ ∑ ∏ ∫ ± ∩ × † ‡ ÷ ≤ ≥ ≡ ≠ ≈

← ↑ → ↓ ↔ ↕ 1 2 3 a ¶ ¼ ½

¾ ™ © ®

∇ ∃ ∅ ∇ ∈

Abstrakt: (100 - 150 words)

Ë, Ç, ë, ç

α β Γ γ Δ δ ε ζ η θ ι κ λ μ ν ξ

Π ρ Σ σ τ υ φ ψ χ Ψ Ω ω

√ ∫ ∂ ∞ ∑ ∏ ∫ ± ∩ × † ‡ ÷ ≤ ≥ ≡ ≠ ≈

← ↑ → ↓ ↔ ↕ 1 2 3 a ¶ ¼ ½

¾ ™ © ®

∇ ∃ ∅ ∇ ∈

Fjalë kyçe shqip:

Fjalë kyçe anglisht:

Fusha shkencore: [Zgjedhe fushën shkencore]

Fertig

Plotësoni ju lutem me kujdes të gjitha fushat e këtij formulari, pasi që këto të dhëna do të përdoren me rastin e publikimit të punimit. Që t'a keni të lehtë plotësimin e fushave për abstraktin, në anën e majtë të fushës do të gjeni shenja dhe simbole të ndryshme matematikore dhe të tjera, të cilat mund të vendosen në abstrakt me vetëm një klikim mbi to.

α β Γ γ Δ δ ε
ζ η θ ι κ λ

λ μ ν ξ Π ρ
Σ σ τ υ φ ψ ζ
Ψ Ψ Ω ω

√ ∫ ∂ ∞ ∑
∏ ∫ ± ∩ × †
‡ ÷ ≤ ≥ ≡ ≠ ≈
← ↑ → ↓ ↔
↕ 1 2 3 a ¶ ¼ ½
¾ ™ © ®

∇ ∃ ∅ ∇ ∈

Këtu disa formula matematikor:

$\nabla \alpha \leq |\beta|, \exists u = 0$

Të keni kujdes që gjatë plotësimit të këtyre rubrikave të formularit, të bëni edhe radhitjen e autorëve në punim (autori i parë, i dytë, i tretë, etj.).

Përcaktoje radhitjen e autorëve në punim:	Një autor nuk mund të jetë në dy e më shumë pozita në punim.
	Ju lutem të radhitni autorët e punimit në atë menyrë, që të keni një autor në një pozitë (i pari, i dyti, etj.).
	Autori i pare : Eshref Januzaj ▾ Autori i dyte : Eshref Januzaj ▾

Përcaktoje radhitjen e autorëve në punim:	Autori i pare : Gjergj Kastrioti ▾
	Autori i dyte : Eshref Januzaj ▾

Poashtu, është **me shumë rëndësi** që të zgjedhni fushën shkencore ku dëshironi që të dërgoni punimin tuaj. Mvarësisht se cilën fushë shkencore e zgjedhni, sistemi ALPA do të bëjë seleksionimin automatik të punimëve dhe ato do t'i dërgoj te redaktori përgjegjës i fushës përkatëse që ju e keni zgjedhur.

The screenshot shows the ALPA submission interface in Mozilla Firefox. The 'Fusha shkencore' dropdown menu is open, displaying a list of scientific fields: Teknologji Informacioni dhe Telekomunikacion, [Zgjedhe fushën shkencore], Shkencat Shoqërore, Drejtësi, Matematikë, Statistike, Biologji, Biokimi (Njeriut, Bimë, Kafshe), Mjekësi, Ekonomi, Teknologji Informacioni dhe Telekomunikacion (highlighted), Albanologji, Tokat Bujqësore, Mjedis, Gjeologji, Metalurgji, Inxhinieri Kimike, Riciklim, Inxhinieri Elektrike, Mekanike, Elektronike, Prodhimi Bimor, Kimi, Fizike, Biokimi. A 'Regjistro' button is visible at the bottom of the form.

Kur të keni plotësuar të gjitha fushat, klikoni mbi butonin “Regjistro” në fund të faqës.


Nëse nuk i keni plotësuar si duhet të gjitha fushat në formular, ALPA do të paraqes gabimin në ekran për fushën që nuk është e plotësuar si duhet me një porosi përkatëse.

The screenshot shows the ALPA submission interface with error messages. The 'Fjalë kyçe shqip' field has the message: 'Te lejuar jane vetem 5 - 7 fjale, kurse ju keni shenuar 1 fjale.' The 'Fjalë kyçe anglisht' field has the message: 'Ju lutem plotesoni rubriken 'Fjalë kyçe anglisht''. The 'Fusha shkencore' dropdown is set to 'Teknologji Informacioni dhe Telekomunikacion'. The author selection fields are filled with 'Gjergj Kastrioti' and 'Eshref Januzaj'. A 'Fertig' button is visible at the bottom.

Nëse çdo gjë është plotësuar ashtu siç duhet, ALPA do t'ua japë mundësinë që të shikoni edhe një herë të dhënat e juaja. Nëse çdo gjë është në rregull, klikoni mbi butonin “Finalizo regjistrimin” në fund të faqës. Nëse vëreni se ka diçka për të korrigjuar, atëherë klikoni mbi butonin “Korrigjo”.


Nëse çdo gjë ka shkuar mire, ju tash e keni mundësinë që të dërgoni dokumentin e plotë - datoteken (file) me punimin tuaj. Si datotekë (file) pranohen vetëm dokumente në formatin DOC dhe që nuk janë më të mëdhaja se 10 MB. Nëse dokumenti i juaj është më i madh se 10 MB, atëherë na kontaktoni në këtë adresë elektronike: AKTET-submit10@alpa.mali-it.eu

Kujdesuni ju lutem poashtu që dokumentet në formatin Microsoft WinWord të jenë me verzionin 2003 ose më të vjetër.



Kur të keni zgjedhur dokumentin që dëshironi duke klikuar në fushën e zbrazët apo në botonin në të djathtë të kësaj fushe, do t'ua paraqitet në ekran një dritare tjetër, përmes së cilës do të mund të zgjedhni dokumentin me punimin e plotë në kompjuterin tuaj. Kur t'ua keni bërë këtë, ju tash mund të shtypni butonin “Dergo kumtesen”.

Nëse çdo gjë ka shkuar në rregull, ju do të merrni porosinë në ekran se punimi i juaj është regjistruar me sukses. KUJDES: Ky hap mund të zgjas disa sekonda!



Me këtë rast ju e keni realizuar me sukses regjistrimin e punimit tuaj dhe në ndërkohe do të merrni përmes postes elektronike edhe konfirmimin për regjistrimin e bërë.